

LIGJ
Nr. 4/2013

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E
EKONOMIVE PYJORE, QË PRITET TË PËRMBYTEN NGA LIQENI I HEC-EVE TË BANJËS,
KOKLIT DHE MOGLICËS, TË CILËT DO TË NDËRTOHEN NË KASKADËN E LUMIT
DEVOLL**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor, që pritet të përmytet nga liqeni, që do të krijohet si rezultat i ndërtimit nga shoqëria “Devoll Hydropower”, sh.a., të hidrocentraleve të Banjës, Koklit dhe Moglicës, në kaskadën e lumit Devoll, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1421,39 (një mijë e katërqind e njëzet e një presje tridhjetë e nëntë) ha, që ndodhet në ekonomitë pyjore/kullosore Gostimë - Koprrik, Mollas, Galigat - Storrë, Gramsh - Vinë, Vidhan - Skënderbegas, Darëzezë - Sult dhe Dushku i Bulçarit të qarkut të Elbasanit, si dhe Lavdar - Opar, Voskopojë, Lozhan dhe Moglicë të qarkut të Korçës, të hiqen nga Fondi Pyjor dhe Kullosor Kombëtar dhe të çregjistrohen nga kadastra kombëtare e pyjeve, sipas tabelës 1 dhe hartave, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 2

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore në terren dhe në hartë, kufijtë e rinj të Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas nenit 1 të këtij ligji, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe “Tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në sipërfaqe ujore (liqen) dhe truall për ndërtimin e HEC-eve, në pronësi publike.

Neni 3

Për sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor dhe për lëndën drusore që do të pritët, shoqëria “Devoll Hydropower”, sh.a. duhet të përfundojë procedurat e pagesës, në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

Neni 4

Shoqëria “Devoll Hydropower”, sh.a., brenda 3 viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 1347,8 (një mijë e treqind e dyzet e shtatë presje tetë) ha me pyje dhe të përmirësojë një sipërfaqe prej 73,6 (shtatëdhjetë e tre presje gjashtë) ha kullotë, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore.

Lloji i drurëve, që do të mbillen, e grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim, me procesverbal, të sipërfaqes së pyllëzuar dhe kullotës së përmirësuar, sipas marrëveshjes

që do të lidhet ndërmjet tyre.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, njësitë e qeverisjeve vendore Tregan, Pishaj, Kodovjat, Skënderbegas, Sult të qarkut të Elbasanit dhe komuna Moglicë e qarkut të Korçës për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.1.2013

Shpallur me dekreten nr. 7946, datë 13.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani